



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2024:030183

Datë: 08.03.2024

Numri i dokumentit: 05428935

**P.nr.34/24**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEGA NË ISTOG - Departamenti i Përgjithshëm,** Gjyqtari i vetëm gjykues Petrit Nrecaj, me procesmbajtësen Hale Ahmetaj, në çështjen penale kundër të pandehurve M.H dhe K.V, për shkak të veprës penale vjedhja e rëndë nga neni 315 par. 1 nën par. 1.1 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (tutje e KPRK), të akuzuar sipas aktakuzës së prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.126/24 të datës 09.02.2024, pas mbajtjes së seancës publike të shqyrtimit fillestar me datë 21.02.2024, në praninë e prokurorit të shtetit Dorjan Juniku, të pandehurit M.H dhe mbrojtëses së tij av. Kaltrina-Hysenaj-Fetahaj, dhe të pandehurit K.V dhe mbrojtëses se tij av. Pranvera Ukaj-Pukaj, të njëjtën ditë mori dhe shpalli ndërsa me datë 08.03.2024, përpiloi këtë

**A K T G J Y K I M**

**Të pandehurit:**

- M.H** nga i ati M.dhe e ëma E. e gjinisë H., i lindur me datë ... në I., me vendbanim në fshatin C.rr. “Xhafer Haskaj” nr.67 Komuna I., i pamartuar, ka të kryer shkollën fillore, i papunë, i gjendjes së mesme ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit nr.... shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, *gjendet ne paraburgim nga data 24.01.2024.*
- K.V**, nga i ati Z. dhe e ëma S. e gjinisë D., i lindur me datë ... në I., me vendbanim në fshatin L. rr. “Gurthyesi Graniti” nr.37 Komuna I., i pamartuar, ka të kryer shkollën fillore, i papunë, i gjendjes së mesme ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr. ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, *gjendet ne paraburgim nga data 24.01.2024.*

**JANË FAJTOR**

**Sepse:**

Me datën 22.01.2024, në kohë të pa caktuar, në fshatin Lubozhdë, Komuna Istog, në rr. “Gurrat e Bardha” nr. 30, pikërisht në shtëpinë e të dëmtuarit Sh.D me dashje dhe në bashkëkryerje, e me qëllim të përvetësimit në mënyrë të kundërligjshme kanë përvetësuar sendet e luajtshme, në atë mënyrë që ditën kritike pas një plani paraprak të pandehurit pasi që sigurohen se ne shtëpinë e të dëmtuarit nuk gjendet askush, fillimisht depërtojnë me forcë duke e thyer dritaren e shtëpisë, për të vazhduar më pas brenda shtëpisë nga ku fillimisht në njërën dhomë nga fioka marrin çelësat e garazhit dhe veturës, e me pas me çelës i pandehuri Kadri hap derën e garazhit, futën

ne brendi, hapin veturën si dhe sende tjera si tri (3) aku, një (1) pajisje të lojërave (Play Station) si dhe disa bateri, një (1) makinë për pastrimin e automjeteve dhe dy (2) burmashina, si dhe atë një (1) veturë të tipit “Passat”, ngjyrë të hirit, me nr. Të karrocërisë WVWZZZ38ZX083809, pa targa, në një vlerë të përgjithshme rreth 800 euro, e me pas largohen nga vendi i ngjarjes, ndërsa veturën me qellim që ta fshehin e dërgojnë në vendin e quajtur “Lluga” e me pas e shesin në shumën prej 550 euro tek një person nga Mitrovica, e cila pas sekuestrimit i kthehet pronarit.

- me çka kanë kryer veprën penale **vjedhja e rëndë nga neni 315 par.1 nën par.1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së**

Andaj, gjykata duke u bazuar në nenin e lartcekur të veprës penale dhe dispozitat e nenit 2, 4, 7, 17, 21, 38, 40, 42, 43, 69, 70 të KPRK-së dhe nenin 242, 364 dhe 369 të Kodit Nr.08/L-032 të Procedurës Penale (tutje KPP-së), të pandehurit i:

### GJYKON

- I.** Ashtu që, të pandehurit **M.H** i shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) vit e tre (3) muaj, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, si dhe i shqiptohet edhe dënimi me gjobë në shumën prej dyqind (200) euro, të cilën gjobë obligohet që ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II.** Ashtu që, të pandehurit **K.V**, i shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) vit e tre (3) muaj, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, si dhe i shqiptohet edhe dënimi me gjobë në shumën prej dyqind (200) euro, të cilën gjobë obligohet që ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- III.** Nëse të pandehurit M.H dhe K.V nuk mundën apo nuk dëshirojnë të paguajnë dënimin me gjobë në afatin kohor të përcaktuar me lartë, atëherë dënimi më gjobë do të zëvendësohet më dënim me burgim, konform nenit 43 par.3 të KPRK-së, ku për çdo njëzet (20) euro të gjobës, do të ju llogariten me një (1) ditë burgim, *përkatësisht nga 10 ditë burgim.*
- IV.** Të pandehurve M.H dhe K.V, ju vazhdohet masa e paraburgimit me aktvendim të posaçëm deri në plotfuqishmëri të këtij aktgjykimi.
- V.** Të pandehurve M.H dhe K.V, në dënimin e shqiptuar me burgim, do të i’u llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 24.01.2024.
- VI.** **OBLIGOHEN** të pandehurit që secili veç e veç në emër të shpenzimeve të procedurës penale, të paguajnë paushallin gjyqësor në shumë prej **njëzetë (20) euro**, ndërsa në emër të taksës për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumën nga **njëzetë (20) euro**, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

**VII. Pala e dëmtuar:** Sh.D nga fshati L., Komuna I., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet ne kontest te rregullt juridiko civil.

## A r s y e t i m

### Rrjedha e procedurës penale

Në këtë gjykatë, Prokuroria Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.126/24 të datës 09.02.2024, kundër të pandehurve M.H dhe K.V për shkak të veprës penale vjedhja e rëndë nga neni 315 par. 1 nën par. 1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestar me datë 21.02.2024, në të cilën seancë kanë prezantuar Prokurori i Shtetit Dorjan Juniku, i pandehuri M.H se bashku me mbrojtësen e tij av. Kaltrina Hysenaj-Fetahaj e caktuar sipas detyrës zyrtare, dhe i pandehuri K.V së bashku me mbrojtësen e tij av. Pranvera Ukaj-Pukaj e caktuar sipas detyrës zyrtare. Ku pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit, gjykata pasi që është bindur se të pandehurit e kanë kuptuar aktakuzën, dhe pas njoftimit me benifitet dhe pasojat e pranimit të fajësisë, ju ka mundësuar të pandehurve të deklarohen për pranimin e fajësisë apo të deklarohen të pafajshëm.

I pandehuri **M.H** pas konsultimit me mbrojtësen e tij av. Kaltrina Hysenaj – Fetahaj ka deklaruar : se e pranon fajësinë për veprën penale për te cilën akuzohet, është i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë, pranimin e fajësisë e bënë në mënyrë vullnetare dhe pa presion nga askush, duke shtuar se është pënduar për këto veprime dhe i premtoj gjykatës se ne te ardhmen do te kem sjellje te mira dhe nuk do te kryej vepra penale.

I pandehuri **K.V** pas konsultimit me mbrojtësen e tij av. Pranvera Ukaj – Pukaj ka deklaruar: se e pranon fajësinë për veprën penale për te cilën akuzohet, është i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë, pranimin e fajësisë e bënë në mënyrë vullnetare dhe pa presion nga askush, duke shtuar se është pënduar për këto veprime dhe i premtoj gjykatës se ne te ardhmen do te kem sjellje te mira dhe nuk do te kryej vepra penale.

**Prokurori i Shtetit**, lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve, ka deklaruar se: pajtohem me pranimin e fajësisë te deklaruar nga ana e te pandehurve për veprën penale për te cilën akuzohen, një pranim i tillë u be ne mënyrë vullnetare dhe gjënë mbështetje ne provat qe gjenden ne shkresa të lëndës, kërkoj nga gjykata qe ketë pranim fajësie te aprovoj si te tillë, ndërsa po ashtu nga gjykata kërkoj qe me rastin e përcaktimit te llojit dhe lartësisë se dënimit pranimin e fajësisë te vlerësoj si rrethanë lehtësuese, ndërsa ne kuptim te dispozitave ligjore te nenit 70 par.2, pika 2.1. 2.2. 2.13 te KPRK-së, si rrethana rënduese te vlerësoj shkallen e lartë te pjesëmarrjes se te akuzuarve ne kryerjen e veprës penale pasi te njëjtit paraprakisht kanë bërë një plan për te kryer këtë vepër penale, pastaj e kanë kryer te njëjtën, shkallen e larte te dashjes ne kryerjen e veprës penale nga se te njëjtit kanë qene te vetëdijshëm se me veprime te tyre do te kryejnë një vepër penale mirëpo për kundër këtij fakti të njëjtit kanë dashur qe vepra te kryhet,

si dhe faktin se këtu i akuzuari M.H nga informacionet mbi te kaluarën e tij konsiston se i njëjti është i dyshuar për nëntë vepra tjera te vjedhjes së rëndë, ndërsa i pandehuri K.V për tri vepra penale te vjedhjes se rende dhe dy vepra penale te vjedhjes.

**Mbrojtësja e të pandehurit M.H** av. Kaltrina Hysenaj-Fetahaj, lidhur me pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i saj ka deklaruar se: pasi që i mbrojturi ime ka bere pranimin e fajësisë pa asnjë presion, lajthim apo mashtrim, si dhe i njëjti është i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë si dhe rrethanat lehtësuese te cila shkojnë ne favor te tij, andaj i propozojmë gjykatës që me rastin e vendimit mbi shqiptimin e dënimit te këtë parasysh kërkim faljen e tij, premtimin që ne te ardhme nuk do te kryej vepra tjetra penale, moshën e tij te re, sjelljen e tij te mirë para gjykatës, gjithashtu i ka propozuar gjykatës që paraburgimi te ndërpritet dhe ti zëvendësohet me ndonjë masë tjetër me te lehtë dhe me këtë do te arrihet efekti i dënimit.

**Mbajtësja e të pandehurit K.V**, av.Pranvera Ukaj-Pukaj, lidhur me pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i saj, ka deklaruar se: pajtohem me pranimin e fajësisë te bërë nga ana e te mbrojturit tim, i cili pranimi i fajësisë është bere pas sqarimit te benifiteve dhe pasojave te pranimin të fajësisë, i njëjti këtë pranim e bën ne mënyrë vullnetare dhe ky pranim fajësie ka mbështetje ne shkresat e lendes, andaj i propozoj gjykatës që te njëjtin pranim fajësie ta aprovoj, dhe gjatë matjes dhe shqiptimit te dënimit, pranimi i fajësisë te merret si rrethanë posaçërisht lehtësuese, si rrethana tjera lehtësuese të merret edhe fakti se i njëjti është penduar për veprën e kryer dhe gjithashtu i ka kërkuar falje edhe pronarit te automjetit te vjedhur si dhe është i gatshëm te beje kompensimin e demit te shkaktuar, ndërsa sa i përket masës se paraburgimit meqenëse kanë pushuar kushtet për të cilat është caktuar kjo masë dhe kërkoi nga gjykata që masën e paraburgimit ta ndërpresë.

#### Vlerësimi i pranimin të fajësisë

Gjykata ne rastin konkret lidhur me pranimin e fajësisë nga të pandehurit, pas marrjes së mendimeve te lartcekura nga prokurori i shtetit dhe mbrojtësit e tyre, si dhe se pas vërtetimit se janë përmbushur kërkesat nga neni 242 par. 1, par. 2 nën par. 2.1, 2.2 dhe 2.3, dhe par.3 të KPP-së, përkatësisht pas vlerësimit se të pandehurit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se ky pranim është bërë në baza vullnetare dhe se mbështetet në faktet dhe provat që përmban aktakuza, po ashtu pas vërtetimit se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike të paraparë me nenin 242 par. 2, nën par. 2.4 të KPP-së, gjykata ka pranuar pranimin e fajësisë nga të pandehurit për veprën penale të lartcekur për te cilën janë akuzuar.

#### Vendimi për shpalljen fajtor

Gjykata nga të lartcekurat ka vendosur që të pandehurit t'i shpall fajtor për veprën penale për të cilën janë akuzuar dhe i ka gjykuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që gjeti se të njëjti janë penalisht përgjegjës dhe se nuk ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale të te pandehurve, po ashtu në veprimet e tyre manifestohen të gjitha elementet subjektive dhe objektive të veprës penale të lartcekur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Pas pranimin të fajësisë nga të pandehurit dhe konstatimit nga gjykata të përmbushjes se kushteve në referim të nenit 242 par. 1, 2 dhe 3 të KPP-së, gjykata ka vlerësuar se nuk është e nevojshme

vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

### Rrethanat që janë marre për bazë me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e marrjes së vendimit sa i përket sanksionit penal, përkatësisht me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, vlerësoi të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese, të cilat konform nenit 69 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, ashtu që për të pandehurin **M.H** si **rrethana lehtësuese** ka gjetur se ka pranuar fajësinë, kompenzimin pjesërisht të dëmit të shkaktuar me vepër penale ngase i është kthyer vetura e vjedhur palës së dëmtuar dhe rrethanat personale se është i moshës së re, është penduar për kryerjen e veprës penale dhe premtimin se ne te ardhmen nuk do të kryej vepra penale; ndërsa **rrethana rënduese** ka gjetur shkallën e lartë të dashjes për kryerjen e kësaj veprë penale ku i pandehuri me vetëdije të plotë ka dashtë që të kryhet kjo vepër penale, të cilat veprime paraqesin shkallët të lartë të frikës dhe pasigurisë në shoqëri dhe cenimit të pronës private; për të pandehurin **K.V** si **rrethana lehtësuese** ka gjetur se ka pranuar fajësinë, kompenzimin pjesërisht të dëmit të shkaktuar me vepër penale ngase i është kthyer vetura e vjedhur palës së dëmtuar dhe rrethanat personale se është i moshës së re, është penduar për kryerjen e veprës penale dhe premtimin se ne te ardhmen nuk do të kryej vepra penale; ndërsa **rrethana rënduese** ka gjetur shkallën e lartë të dashjes për kryerjen e kësaj veprë penale ku i pandehuri me vetëdije të plotë ka dashtë që të kryhet kjo vepër penale, të cilat veprime paraqesin shkallët të lartë të frikës dhe pasigurisë në shoqëri dhe cenimit të pronës private, si dhe sjelljen e mëparshme të pandehurit i cili ka qenë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë në Gj.Th.Pejë – Dega në Klinë, në çështjen penale me numër të SMIL-it 2021:1286365. Andaj, Gjykata në rastin konkret nga rrethanat e lartcekura, ka vlerësuar se dënimet e shqiptuara ndaj të pandehurve dhe të precizuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, janë në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikoj në risocializimin dhe riedukimin e këtu të pandehurve, të cilët do ta kuptojnë rëndësinë e veprës penale të cilën e kanë kryer dhe në këtë mënyrë të njëjtë do të reflektojnë që në të ardhmen mos të shkaktojnë veprime të ndaluara- përkatësisht mos të kryej vepër penale, si dhe do të ndikoj tek personat tjerë të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit konform nenit 38 të KPRK-së.

Gjykata, në kuptim të dispozitave të nenit 71 par.1 dhe nenit 72 të KPRK-së, e ne referim të gjitha rrethanave lehtësuese e sidomos pranimin e fajësisë, ndaj të pandehurve në këtë çështje penale ka aplikuar dispozitat për zbutje të dënimit me burgim nën kufirin e paraparë ligjor – minimum, për veprën penale e cila ju vihet në barrë, duke vlerësuar se edhe me dënimet e shqiptuara ndaj të pandehurve të precizuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet qëllimi i dënimit.

### Shpenzimet e procedurës

Gjykata duke vendosur lidhur me shpenzimet e procedurës, në kuptim të nenit 452 par. 1 dhe nenit 449 par. 2 të KPP-së, i ngarkoi të pandehurit me shpenzimet e procedurës të precizuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e po ashtu konform të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të

Krimet, i obligoi të paguajnë shumën në emër të taksës për programin për kompensimin e viktimave të krimit.

Udhëzimi i palës së dëmtuar për kërkesat pasurore-juridike

Vendimi për udhëzimin e palëve të dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil, është marr konform nenit 462 par.2 të KPP-së.

Gjykata duke u bazuar në arsyet e lartshënuara e në bazë të neneve 242, 364 dhe 369 të KPP-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEGA NË ISTOG**  
**Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal**

**Procesmbajtësja**  
**Hale Ahmetaj**

**Gjyqtari i vetëm gjykues**  
**Petrit Nrecaj**

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit të Kosovë në Prishtinë, *në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.*